



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Direktorat za Kulturë, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport - Kültür, Gençlik ve Spor Müdürlüğü

RISHPALLJE E KONKURSIT PËR SKULPTURA MONUMENTALE

Komuna e Gjiçanit ju njofton se rishpall konkursin për monumentet skulpturore dhe fton të gjithë krijuesit artistik vendor dhe mbarëkombëtar të konkurrojnë dhe prezantojnë konceptet e tyre urbane për hapësirat publike të dedikuara për vendosjen e këtyre veprave skulpturore duke pasur parasysh këto specifika:

1. Skulpturat duhen të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me emërtimet e përcaktuara të monumenteve dhe për t'u vendosur në një prej ambienteve publike përgjatë hapësirave të përcaktuara për vendosjen e skulpturave monumentale në qytetin e Gjiçanit.
2. Autorët mund të konkurojnë me nga një vepër për secilën nga këto emërtime.
3. Punimet fizike në formë boceti jo më të vogël se 60 cm, përshkrimi i shkurtër me fjalë i veprës, fotomontazhi i bocetit në hapësirën e përcaktuar për vendosjen e monumentit me shifër personale dhe me emërtim adekuat të monumentit sipas thirrjes publike duhet të dorëzohen në ish Galerinë e Qytetit në Gjiçan më saktësisht në katin e dytë të Teatrit të Qytetit, ku edhe do të ekspozohen para qytetarëve të Gjiçanit dhe grupeve të ndryshme të interesit të përgjithshëm, t'i nënshtrohen një analize dhe mendimi të përgjithshëm përmes një libri të mendimeve i cili do të lehtësoj punën e komisionit profesional vlerësues në përzgjedhjen adekuate.
4. Plotësimi i formës së aplikimit, formulari i aplikimit duhet të ketë emërtimin adekuat të monumentit, të përmbajë shifrën identik me atë të punimit fizik, koston e përgjithshme të realizimit, email adresën dhe numrin e telefonit, të nënshtrohet nga autori pa emër dhe mbiemër. Format e aplikimit nuk do të hapen deri në përzgjedhjen finale të punimeve.
5. Formulari i aplikimit duhet të vendoset në një zarf të mbyllur dhe të dorëzohet në Zyrën përkatëse. Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme: **Qendra për Shërbim të Qytetarëve, ish Bankosi, Komuna e Gjiçanit.**

Në pjesën e jashtme të zarrfüt duhet të shënohet:

PËR KOMUNËN E GJILANIT

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

THIRRJE PUBLIKE PËR SKULPTURA MONUMENTALE

TË MOS HAPET PARA TAKIMIT TË KOMISIONIT VLERËSUES

Afati për dorëzimin e propozimeve është nga data 01 shtator 2021 deri me 21 shtator 2021

1. Monumenti i gruas “HEROINA E QYTETIT”

(Kjo vepër artistike monumentale i dedikohet të gjitha femrave dhe grave pa dallime të cilat dhanë kontribut jetësor për gjenerata të tëra në të gjitha sferat e jetës në Komunën e Gjilanit).

Dimenzioni: lartësia, max. 4 – 5 m

Materiali: bronz, metal.

2. Monumenti i mërgimtarëve “GURBETQARI”

(Kjo vepër artistike monumentale i dedikohet të gjithë mërgimtarëve në shenjë respekti për punën, solidaritetin, mbështetjen, pjesëmarrjen dhe ndërtimin e ëndrrës sonë, që e bënë realitet baballarët tanë).

Dimenzioni: lartësia, max. 4 – 5 m.

Materiali: bronz, metal.

3. Monumenti i rinise dhe fëmijëve “ANDRRA”

(Kjo vepër artistike monumentale i dedikohet moshave rinore dhe fëmijëve si ardhmëria e jonë).

Dimenzioni: të lira, sipas hapësirës ekzistuese.

Materiali: bronz.

4. Monumeti i sportit ” **SPORTISTI**”

(Kjo vepër artistike monumentale i dedikohet të gjithë sportistëve pa dallime si dhe të ketë simbolikën e lartësimit dhe gjithëpërfshirjes).

Dimenzioni: lartësia, max. 3 – 4 m.

Materiali: bronz, metal.

5. Monumenti i arteve dramatike “**DRAMA SHQIPE**”

(Kjo vepër artistike monumentale i dedikohet Teatrit të Qytetit në formën reliefore, e cila pasqyron historikun e traditës teatrore si dhe dramës origjinale shqipe e cila tashmë është tradicionale në festivalin mbarëkombëtar kulturor Flaka e Janarit dhe Talia e Flakës).

Dimenzioni: gjatësia 23.54 m x gjerësia 159 cm.

Materiali: poliester.

6. Monumenti i qytetit tim – “**TOLERANCËS DHE PAQËS**”

(Kjo vepër artistike monumentale i dedikohet qytetarëve të qytetit të Gjilanit të cilët i karakterizon toleranca, mirëkuptimi dhe traditat. Ky monument mund të krijohet në formate dhe teknika të ndryshme varësisht prej idesë e konceptit të autorit)

Dimenzioni: E lirë, sipas autorit

Materiali: E lirë sipas autorit

Gjilan, 01 shtator 2021



Lutfi Haziri

Kryetari i Komunës